

FJALA E DEPUTETIT FLORENC SPAHO

Ë HËNË DATA 05 QERSHOR 2023

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Në fakt, mendoj se zgjedhjet e 14 majit mbaruan dhe nuk dëshiroj të zgjatem, sepse qytetarët folën dhe na votuan në të gjithë Shqipërinë, kryesisht në qarkun e Elbasanit, ku patëm një rezultat historik 7 me 0 për bashkitë e Elbasanit. Por, meqenëse jam deputet i Elbasanit dhe kolegu Noka foli për Elbasanin, për zgjedhjet farse, për intimidim votash, qytetarët e Elbasanit nuk harrojnë, sepse ka dalë edhe në medie apo në portale, që zoti Noka hynte nëpër qendrat e votimit duke intimiduar vëzhguesit dhe anëtarët e komisionit. Gjithashtu, qytetarët e Elbasanit nuk mund t'i harrojnë ato më shumë se 20 makina, si një eskortë, që lëviznin rrugëve të Elbasanit natën, kryesisht rrugëve të lagjeve periferike. (Ndërhyrje nga salla) Po, patjetër, kemi edhe targat e atyre makinave që lëviznin, të cilat drejtoreshin nga pjesëtarë të opozitës apo të grupit "Bashkë fitojmë", nuk e di, një parti që thotë se quhet "Partia Demokratike", por te emrat që janë vënë te këshillat bashkiakë të Elbasanit nuk është asnjë nga PD-ja, janë të gjithë të partisë tjetër, por gjithsesi.

Zonat që unë mbuloj janë rajoni 2 dhe rajoni 3. Këtu dua të falënderoj të gjithë ekipin e palodhur të PS-së, në mënyrë të veçantë rajonin 2 në Elbasan, që për herë të parë, pas shumë vitesh, edhe pse njihej si një zonë që shpesh mund të dilte barazim apo mund të fitonte opozita, vlerësoi PS-në! Ju e morët përgjigjen e merituar, sepse u munduat të intimidoni votat, duke u futur me nga 20 makina eskortë në këtë lagje për të intimiduar edhe qytetarët, madje këtë përgjigje e morët edhe nga lagjja "Brigada" në Elbasan, që votuan PS-në, pra nga qytetarët dhe banorët e kësaj lagjeje të mrekullueshme, sepse nuk mundën t'i bashkëngjiteshin asaj kërkesë që vinte nga opozita. Unë nuk dua të flas shumë për zgjedhjet, sepse qytetarët folën më 14 maj. Ata na besuan, sepse ne dimë të punojmë. Patjetër që duam të bëjmë akoma më shumë, por mundësia nuk është aq e madhe sa dëshira, e cila është shumë herë më e madhe. Ne dimë të kërkojmë falje nëse nuk i kemi arritur objektivat, por jo për fajin tonë. Edhe sot, afërsisht 3 javë pas zgjedhjeve, vijmë në parlament dhe themi: ishin zgjedhje farse; kanë intimiduar; kanë bërë këtë, kanë bërë atë. Por, siç e thashë, nuk dua të ndalem dhe të flas shumë për zgjedhjet, por dua të falënderoj të gjithë qytetarët e Elbasanit për votëbesimin dhe përgjegjësinë që na kanë dhënë! Gjithashtu, dua të falënderoj Shoqatën e të Verbërve në Elbasan, me të cilët diskutuam javën e "gjelbër"! Ata më deleguan dhe më besuan të sjell një çështje që i shqetëson. Ne jemi këtu për të sjellë çdo problematikë që na adresohet nga qytetarët për të marrë një zgjidhje. Shoqata e të Verbërve në Elbasan përbëhet nga 800 anëtarë. Mua më kontaktoi një grup i vogël, të cilët kishin 2 apo 3 kërkesa. Sinqerisht ngela i suprizuar, sepse ne kemi bërë shumë për këto shtresa, por ka edhe shumë për të bërë. Ata kërkojnë që shoqëruesve të këtyre njerëzve, që janë në grupin e parë, t'u njihet siguracioni. Nëse një person i këtij grupi ka edhe bashkëshorten me aftësi të kufizuara, nuk mund ta marrë këtë pagesë, ndaj ata kërkojnë që kjo pagesë

t'u kalojë atyre dhe ta zgjedhin vetë personin që do të jetë shoqëruesi dhe ndihmësi i tyre. Gjatë viteve 2005 – 2010, sipas ligjit në fuqi të asaj kohe, pensionet e invaliditetit rriteshin vit për vit. Më shumë se 100 persona të këtij grupi nuk e kanë përfituar këtë rritje, ndryshe nga shumë shoqata në qytete të tjera, që e kanë apeluar, e kanë çuar në gjykatë dhe e kanë përfituar këtë rritje. Kjo shoqatë e ka bërë kërkesën në gjykatë që para 4 vjetësh dhe pret që t'i dalë data e gjyqit për ta përfituar atë. Një informacion: të njëjtën gjë ka bërë edhe Shoqata e të Verbërve në Durrës, edhe në Berat, e cila e ka përfituar para muajit dhjetor. Duke i falënderuar për besimin dhe për delegimin e kësaj çështjeje shumë shqetësuese që i përket kësaj shtrese, shpresoj që institucionet ta marrin në konsideratë. Faleminderit!